




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPŠTINA OBILIĆ – KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

Në bazë të nenit 5,pika 3.1 dhe 3, të nenit 24,35 pika 4,50 pika 3,76,92, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit ,nr 03/L-025 , të Ligjit për Mbeturina si dhe të dispozitave të nenit 12 dhe 17 nën pikën (e) të Ligjit për vetqeverisje lokale nr.03L-040,dhe dispozitave të nenit 72 nën pikën (3) të statutit të Komunës së Obiliqit të dt.10/03-2010, në mbledhjen e mbajtur me31/05-2010, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

1.Dispozitat e Përgjithshme

Neni -1

Me këtë rregullore krijohet baza juridike për mbrojtjen e Mjedisit në nivel local për qytetarët e komunës së Obiliqit (më poshtë e quajtur Komuna), në mënyrë që të jet i përballueshëm dhe në përputhëshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Neni- 2

Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen dhe përparimin e Mjedisit duke përfshir detyrimin dhe përdorimin me përgjegjësi të resurseve natyrore, me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për Mjedisë të shëndetëshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Neni -3

Organet komunale marrin pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit në bazë të autorizimeve dhe detyrave të dala nga dispozitat ligjore dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje

Neni- 4

Komuna është përgjegjëse për këto çështje mjedisore :

4.1-Krijimin e standardeve në bazë të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit ,të akteve tjera nënligjore të nxjerra në bazë të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje për operatorët locale,në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

4.2-Mbikqyrë aktivitetet,përputhëshmerin e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore të operatorëve të cilët veprojnë në territorin e komunës

4.3-Aprovimin e planeve dhe programeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit për territorin e Komunës;

4.4-Krijimin e masave të arsyeshme për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshem ekonomik,në pajtim me Ligj,aktet tjera të nxjerra në pajtim me Ligjin dhe më këtë Rregullore.

4.5-Krijimin e masave që kanë për qëllim kontrollin e nivelit të zhurmës në territorin e Komunës;

4.6-Mbaj shënime të cilat përfshijnë të dhënat për të gjitha aktivitetet , aplikimet për Leje mjedisore komunale, licenca dhe autorizime tjera mjedisore

4.7-Sigurojnë qasje të pa pengueshme në informata mjedisore dhe të mundësojnë pjesëmarrjen e publikut

4.8-çështjet tjera mjedisore që dalin nga Ligji dhe dispozitat tjera plotësuese të nxjerra në pajtim me ligjin.

Neni- 5

Objektivat kryesore në përputhje me zhvillimin e qëndrueshem ekonomik në Komunë janë:

5.1-zvogëlimi gradual i ndotjes,degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe zvoglimin ose ndalimin e atyre aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve tjera që paraqesinë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;

5.2-mbrojtja e balancit të përgjithshëm ekologjik në territorin e Komunës;

5.3-shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshem i burimeve natyrore dhe tokës bujqësore;

5.4-mbrojtja e monumenteve të rralla natyrore,dhe

5.5-Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror.

Neni- 6

6.1. Instrumentet për mbrojtjen e mjedisit.

1. Mbrojtja e mjedisit rregullohet me:

1.1. infrastrukturë ligjore;

1.2. dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;

1.3. instrumentet ekonomike;

1.4. dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis;

1.5. instrumentet për monitorimin e mjedisit;

1.6. menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik

6.2. Individëve, ndërmarrjeve dhe organeve dhe organizatave tjera iu ndalohen aktivitetet që pa arsyeshmëri rrezikojnë peizazhet natyrore dhe monumentet me vlera të rralla natyrore nën mbrojtje në territorin e Komunës.

6.3. Organet dhe organizatat tjera në nivel komunal janë të obliguara që të bashkëpunojnë dhe ti koordinojnë aktivitetet në zhvillimin dhe përvetësimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

II. SHFRYTËZIMI DHE MBROJTJA E RESURSEVE NATYRORE

Neni-7

Të drejtat dhe detyrimet

7.1. Personat juridikë ose fizikë mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

a). Projektet të cilat i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), në përputhje me nenin 9 pika 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe nenit 7 të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis nr.03/L-24 dhe shtojcave të këtij ligji, projekti i rehabilitimit duhet të përfsihet në raportin VNM.

b). të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat lidhur me aktivitetet e tij;

c). nëse burimi natyrore është pronë publike, të ketë koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër adekuate për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve në përputhje me ligjin;

d). gjatë aktivitetit të zvogëlojë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij dhe

e). pas ndërprerjes së veprimtarisë, të rehabilitojë ose rikthejë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit.

Neni-8

Pëlqimi për shfrytëzim

8.1- Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

8.2- Pëlqimin nga paragrafi 1. të këtij neni e jep Ministria.

Neni- 9

Detyrimet e shfrytëzuesit

9.1-Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të cilat duhet të parandaloj ndotjen e mjedisit.

9.2-Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar,

Neni-10

Vlerat e mbrojtura të natyrës

1. Vlerat e mbrojtura të natyrës përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

2. Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, geomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

Neni-11

Shfrytëzimi i hapësirës

1. Me planet hapësinore dhe urbane përcaktohen zonat e ndërtimit në lokacionet e caktuara, varësisht nga kapaciteti i pranueshëm i ndotjes së mjedisit dhe qëllimeve të ndërtimit.

2. Në zonat e mbrojtura lejohet kryerja e aktiviteteve në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e veçanta, në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit.

Neni -12

Sipërfaqet publike të gjelbëruara

1. Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në planet hapësinore dhe urbane, ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.

2. Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe maseve të përcaktuara me PZHUK dhe PRRK. të përcaktuara nga komuna.

Neni- 13

Mbrojtja e ajrit

Subjektet të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit janë të obliguar që ,me masa tekniko-teknologjike dhe masat tjera,të sigurojë që shkarkimet dhe shprëndarjet në ajer të jenë në kufijtë e vlerave të perkufizuara dhe përcaktuara me ligj dhe aktet tjera nënligjore

Neni-14

Mbrojtja e ujit

14.1.Në përputhje me aktet e veçanta normative të Qeverisë ,dhe me mundësit e Komunës që të përballojë këto nivele,do të themelohen nivelet maksimale të lejshme të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve të ujit.

14.2.Duke rrespektuar standardet dhe rregullat mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:

a).shkarkimi në ujëra i materieve kontaminuese,të ngurta, të lëngëta ose të gazta,organizmave të gjalla duke përfshirë edhe organizmat e modifikuara gjenetikiisht dhe formave të energjisë që shkaktojnë ndryshimin e kthjelltësisë,dekantimit,shtresimit dhe aromës ose ndryshime tjera në cilësinë e ujit;

b).shkarkimi në sistemet publike të kanalizimit i ujërave të ndotura, të cilat përmbajnë substancat mbi vlerat e përkufizuara ose materialet të dëmshme,të cilat mund të shkaktojnë probleme në sistemin e kanalizimit ose objekteve për pastrimin e ujit;

c).përdorimi i puseve të braktisura si gropa septike për ujëra të ndotura.

Neni-15

Mbrojtja e tokës

Personat juridikë dhe fizike të cilët me aktivitetet e tyre në territorin e Komunës,bëjnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore,grumbullimin e mbeturinave,hirit,ngjyrës ose materialeve tjera,ose shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit,duhet të riformojnë shtresën sipërfaqësore të tokës,rivendosin regjimin e mëparshëm ujqor dhe stabilitetin gjeo-mekanik të tokës gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve.

Neni-16

Mbrojtja nga zhurma

Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit,në përputhje me dispozitat e nxjerra nga MMPH,ndërmerr masa për mbrojtjen nga zhurma në përputhje me aktet e LPH,përkatësisht nga PZHK dhe PZHU ,caktojnë zonat e vendbanimeve,zonat për pushim dhe rekreacion si dhe bëjnë matjet sistematike të zhurmës dhe vibrimeve.

Neni-17

Mbrojtja e natyrës

17.1.Zonat me vlera të veçanta natyrore,me interes për Komunën,gëzojn mbrojtje të veçant me ligj dhe aktet të tjera të nxjerra në pajtim me ligjin.

17.2.Mbrojtja dhe ruajtja e tëresishme e natyrës,në territorin e Komunës ,shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave natyrore,kategorizimi i zonave me vlera të veçanta,procedura e vënies nën mbrojtje,mbrojtja e llojeve të rralla e të rrezikuara të florës dhe faunës,regjimi i mbrojtjes sipas shkallës së kategorizimit,mënyra e menaxhimit të tyre,pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje mbi natyrën si dhe mbikqyrja profesionale e zonave me vlera të veçanta të natyrës bëhet në bazë të dispozitave të veçanta ligjore.

Neni -18

Materiet e rrezikshme

1. Personi juridik ose fizik i cili administron me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që të ndërmer të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë për të minimizuar rrezikun për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Neni -19

Administrimi me mbeturina

Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtoratin për Shërbime Publike, në përputhje me aktet që nxjerrë Qeveria e Kosovës, do të përcaktojë rregullat e veprimt, do të hartoi planin për menaxhimin e mbeturinave komunale në territorin e Komunës. Keto rregulla do të përmbajnë kërkesat teknike dhe kriteret për :

- a). vendndodhjen ose krijimin e një strukture për mbajtjen dhe hedhjen e mbeturinave;
- b). lokacionin, klasifikimin, vendosjen dhe transportimin e mbeturinave;
- c). ripërpunimi, shfrytëzimin dhe metodat tjera të ripërdorimit të mbeturinave.
- d). mbledhjen, shkatërrimin ose trajtimin e mbeturinave, dhe;
- e). përdorimin e mbeturinave si material për prodhimin e energjisë, materialeve të papërpunuara, etj.
- f). Ndalohet hedhja e mbeturinave kom. Në mjedis jashtë lokacionit të destinuar për hedhje të mbeturinave kom.**

III-DOKUMENTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni-20

Planifikimi hapësinor

20.1 Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm në bashkëpunim me Drejtoratin për Mbrojtjen e Mjedisit, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe akteve të tjera të nxjerra në bazë të tij, do të hartojë:

- planin zhvillimor komunal
- planin zhvillimor urban
- planet rregulluese

20.2. Plani zhvillimor komunal dhe plani zhvillimor urban do të :

- a). përshkruaj masat për mbrojtjen e natyrës, monumentet me vlera të rrala natyrore nën mbrojtje, ujë, tokës, hapësirave të gjelbëruara dhe zonave rekreative
- b). definojë rrezikun mjedisor të lokacioneve të ndotura, lokacioneve të rrezikuara nga erozioni, nga hedhja e materialeve të papërpunuara dhe të definojë propozimin e masave për rehabilitimin e lokacioneve të tilla.

c).përcaktojë masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit për hapsirat e dedikuara për eksploatimin e resurseve natyrore, respektivisht, ku do të ndërtohen objektet industriale dhe energjetike, objektet për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave, objektet të infrastrukturës dhe objektet tjera, me ndërtimin ose shfrytëzimin e të cilave mund të rrezikohet mjedisi.

20.3-Vlerësimi I aktiviteteve të planifikuara përfshin analizimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit,ndikimin e mundshëm në mjedis të aktiviteteve të planifikuara,veprimet për zbutjen e tij dhe zhvillimin ekonomik.

20.4-Plani zhvillimor komunal ,para aprovimit ,I dërgohet në vleresim MMPH-or per Pelqim mjedisor

20.5-.Planin nga paragrafi paraprak e miraton Kuvendi i Komunës.

Neni- 21

Plani local i veprimit në Mjedis dhe Programet Mjedisore

21.1-Drejtorija për mbrojtje të mjedisit do të hartoi Planin local të veprimit në Mjedis dhe Programet Mjedisore për mbrojtjen e mjedisit

21.2- Në hartimin e planeve të veprimit lokal dhe programeve mjedisore, marrin pjesë. publiku,OJQ-të, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit.

Neni-22

Raporti për gjendjen e mjedisit

22.1-Drejtorija për Planifikim,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,në bashkëpunim me Drejtoritë tjera,i paraqet Kuvendit të Komunës raport njëvjeçar për gjendjen mjedisore në Komunën

Raporti përfshin ,veç tjerash, të dhëna për :

a).gjendjen egzistuese të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis;

b).ndikimet mjedisore në shëndetin e banorëve të Komunës

c).dëmet mjedisore

d).qëndrushmërin e përdorimeve të burimeve natyrore;

e).implementimin planeve lokale për veprim në mjedis në Komunën dhe planeve tjera,si dhe efektin e tyre në zhvillim ekonomik.

f).marrja e masave për mbrojtjen e natyrës,si dhe efektet nga masat marra në zhvillimin ekonomik.

g).analizat për funksionimin e Drejtorië për Mbrojtjen e Mjedisit.

h).evaluimin e shpenzimeve në të kaluarën,të tanishmën dhe të ardhmën për ndikimin ekonomik në aktivitetet mjedisore të bëra nga Drejtorati për Planifikim,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

IV-MASAT DHE KUSHTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni-23

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)

23.1-Personi,ndërmarrja apo organi publik që planifikon të ndërtoj apo të modifikojë një projekt industrial në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe ndryshimet e teknologjisë,rekonstruimin,zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut është i obliguar t'i nënshtrohet procedurës për Vlerësim të ndikimit në mjedis

23.2- Vlerësimi i ndikimit në mjedis, përfshinë projektet nga lëmenj të industrisë, xehetarisë, energjetikës , komunikacionit, turizmit, bujqësisë , pylltarisë , ujërave dhe veprimtarive komunale, si dhe të gjitha projektet të cilat planifikohen në zonat e mbrojtura të natyrës dhe në rrethinën e mbrojtur të vlerës së paluajtshme të kulturës.

23.3- Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik pa të cilin nuk mund të fillon zbatimi i projektit dhe kryhet në përputhje me procedurën sipas ligjit nr,03/L-024.

23.4- Komuna nuk do të lëshoi lejen për ndërtim apo kryerje të aktiviteteve,nëse një projekt i tillë është subjekt i VNM,dhe për të cilin nuk është siguruar Pëlqimi Mjedisor,respektivisht Leja Mjedisore nga autoritetet kompetent(MMPH).

Neni-24

Leje Mjedisore Komunale

24.1. Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshira në nenet 29, 30,31 dhe 33 të Ligjit për mbrojtje të Mjedisit nr.03/L-25 dhe nenit-11 të nënparagrafit1.2 të paragrafit-1 të Ligjit për vlersimin në mjedis nr.03/L-24 , të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis, lëshohet Leje Mjedisore Komunale që është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik.

24.2. Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore.Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

24.3. Lejen Mjedisore Komunale e lëshon komuna.

Neni-25

Masat e reabilitimit

25.1.Kur mund të dëshmohet për neglizhencës,aktet e paramenduara apo shkeljet nga ana e një personi,ndërmarrjeje apo organi publik në territorin e Komunës që sjell një dëm apo aksident mjedisor,personi,ndërmarrja apo organi publik do të detyrohet ta kthejë pjesën e dëmtuar në gjendje që nuk paraqet rrezik për shëndetin publik apo në gjendjen të përgjithshme regjeneruese të pjesës së dëmtuar.

25.2.Në rast se një person ,ndërmarrje ose organ publik në territorin e Komunës merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjellë dëm ose aksident mjedisor,personit,ndërmarrjes apo organit publik do t'i kërkohet të ndërmarrë masa të arsyeshme që të sigurojë se aktivitetet e tilla në të ardhmen të behen në mënyrë që të :

- a).zvogëlon shkarkimin dhe shprëndarjen e nivelit të lejueshëm dhe
- b).minimizohet rreziku për një aksident mjedisor.

25.3.Nëse pala përgjegjëse për dëmin mjedisor nuk mund të vërtetohet ose në rastet kur personi apo ndërmarrja nuk kanë fonde të mjaftueshëm të rregullojnë dëmin mjedisor ,Komuna, në rast se dëmi paraqet rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik, mund të hartojë dhe të implementojë një program të arsyeshëm për rregullimi e dëmit.

25.4-Në rastet kur, identiteti i palës zbulohet, Komunës do ti paguhen mjetet e shpenzuara për rehabilitimin e dëmit.

V-MASAT E VEÇANTA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni-26

Planet e intervenimit(emergjente)në rast të aksidentit mjedisor

26.1- Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

26.2- Planet e intervenimit nga paragrafit 1. të këtij neni përmbajnë; llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

26.3-Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mundë të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

VI-KUSHTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni-27

Standardet dhe vlerat kufitare të emisionit dhe cilësisë të mjedisit

Qeveria me akt nënligjor do ti përcakton standardet dhe vlerat kufitare të emisionit dhe cilësisë të mjedisit të materieve ndotëse dhe energjisë duke përfshirë edhe emisionin nga burimet e palëvizëshme dhe të lëvizëshme në ajër, ujë dhe tokë.

Neni-28

Paralajmrimi i publikut

Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit,në bashkëpunim me drejtorit përkatëse nxjerr Vendimin për paralajmërimin ,rekomandimet dhe masat mbrojtëse të popullatës në territorin e Komunës në raste të ndotjes e cila tejkalon nivelet kritike të vlerave të kufizuara për shkarkimin dhe shpërndarjen e materieve ndotëse,përfshirë materialet ndotëse të ngurta,të lëngta dhe të gazta në ajer ,ujë dhe tokë.

Neni-29

Detyrimi për njoftim dhe bashkëpunim

29.1.Kushdo që ka ose që mund të ketë dijeni për dëmtim të mjedisit ose aksident ekologjik duhet të njoftojë Drejtoratin për Mbrojtje të Mjedisit për këto probleme.Institucionet komunale do të bashkëpunojnë me Inspektoratin Mjedisor Qëndror(MMPH),në kërkimin e arsyes për demet specifike mjedisore në territorin e Komunës.

29.2.Policia dhe zyrtarë publik tjerë të autorizuar,të cilët gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre vijnë në dijeni lidhur me aksidentet ekologjike ose çrregulime tjera mjedisore në territorin e Komunës,do të njoftojnë menjëherë institucionet e lartëcekura në nenin 12.1.

29.3.Institucionet Administrative të Komunës do të bashkëpunojnë me ato të MMPH në gjetjen e shkaqeve të çrregulimeve mjedisore dhe të përgjegjësit për çrregullime.

Neni-30

Statusi i Mjedisit të Rrezikuar

Komuna e Obiliqit do të kërkojë pëlqim nga Qeveria të trajtohet si zonë me Statusin e mjedisit të rrezikuar

Neni-31

Shpallja e gjendjes së rrezikshmërisë

Në rast të aksidentit mjedisor, varësisht nga përmasat, brenda ose jashtë pajisjeve dhe vlerësimit të pasojave të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt ose të tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut , komuna e shpallë gjendjen e mjedisit të rrezikuar dhe për këtë e njofton publikun për masat e ndërmarra

VII-KONTROLLI DHE INFORMIMI PËR NDOTJE TË MJEDISIT

Neni-32

Monitorimi

32.1-Komunat, në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.

32.2- Personat juridik ose fizik të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre e ndotin mjedisin,në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.

Neni-33

Të dhënat për mbrojtjen e mjedisit

Drejtorija për Mbrojtje të Mjedisit mban të dhëna, të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit,e të cilat përfshijnë pa kufizim:

- a).të gjitha subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuar due veprimtaritë e tyre;
- b).kërkesat për miratim,licencat due autorizimet të tjera të tilla që kërkohen e jepen dhe çdo informacion të mëtejshem në lidhje me to;
- c).çfardo informacioni tjetër të marrë ose të siguruar sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit apo akteve tjera normative;
- d).hollësi për gjoba të vendosura sipas Ligjit dhe akteve tjera normative.

VIII-INFORMIMI DHE PJESMARRJA E PUBLIKUT

Neni-34

Qasja në informata

1. Komuna është e detyruar që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, respektivisht për dukuritë të cilat janë duke u përcjellë në kuadër të monitorimit të emisionit dhe cilësisë të mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut, në përputhje me ligj.

Neni-35

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

Komuna duhet të sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për projektet mjedisore që kanë ndikim në shëndetin public

IX-DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSIA PËR NDOTJEN E MJEDISIT

Neni 36

Detyrimet e personave juridik dhe fizik

1. Personat juridik dhe fizikë janë të detyruar që gjatë të gjitha fazave të kryerjes së aktiviteteve të tyre të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit përmes:
 - 1.1. zbatimit të standardeve dhe normave ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
 - 1.2. shfrytëzimit racional të resurseve natyrore
 - 1.3. aplikimit të teknologjive të pastra;
 - 1.4. shfrytëzimit të resurseve natyrore të përtritshme;
 - 1.5. përdorimit të prodhimeve, proceseve, teknologjive dhe praktikave të cilat e rrezikojnë më pak mjedisin;
 - 1.6. ndërmarrjes së masave parandaluese ose mënjanimi të pasojave të rrezikimit dhe dëmtimit të mjedisit;
 - 1.7. mbajtjes së evidencës sipas procedurës së përcaktuar me ligj;
 - 1.8. kontrollit të aktiviteteve dhe punës së pajisjeve të cilat mund të paraqesin rrezik ose mund të shkaktojnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
2. Masat për mbrojtjen e mjedisit nga paragrafi 1. i këtij ligji, personat juridik dhe fizikë i kryejnë në mënyrë të pavarur ose përmes organizatës së autorizuar.

Neni-37

Përgjegjësia për ndotjen e mjedisit

1. Ndotësi i cili shkakton ndotjen e mjedisit, përgjigjet për dëmin e shkaktuar dhe bartë shpenzimet për vlerësimin dhe eliminimin e dëmit.
2. Për ndotjen e mjedisit, është përgjegjës personi juridik ose fizik i cili në mënyrë të paligjësme ose përmes veprimit të gabuar ka shkaktuar ose ka lejuar ndotjen e mjedisit.

X-FINANCIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni-38

Komuna në kuadër të drejtave dhe Buxhetit të vet, sigurojnë financimin dhe realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

Neni-39

Kompensimet që i cakton komuna

1.Komuna e Obiliqit cila e ka terotorin më të rrezikuar mjedisor do të përcakton kompensimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.

2.Për caktimin e lartësisë për kompensimin nga paragrafi 1 i këtij neni, mënyrën e pagesës, si dhe lehtësimet për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin,sipas Rregullores komunale për ngarkesa dhe tarifa

XI.MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni -40

40.1-Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e çrregullimeve mjedisore në territorin e Komunës,ndikimi I të cilave nuk kalon kufijtë e Komunës dhe të cilat mund të zgjidhen,kontrollohen dhe parandalohen nga organet komunale,e bën Inspektori për Medis

40.2-Punët e inspektorit mund t'i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna.

40.3- Personat juridik ose fizik, veprimtaritë dhe aktivitetet e të cilëve i nënshtrohen mbikëqyrjes,janë të detyruar që inspektorit t'i mundësojnë zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, ti ofrojnë dokumentacionin dhe të gjitha të dhënat e nevojshme.

Procedura e ankesës

Neni -41

41.1.Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese,në rastet e marrjes së masave për urdheresa dhe ndalesa,inspektori i mjedisit nxjerr vendim.

41.2.Kundër vendimit të inspektimit të inspektorit komunal për mjedis,ankesa i drejtohet Kryetarit të Komunës .

XII-DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 42

Me gjobë prej 1000.€ deri në 1500 € për shkelje ekologjike do të dënohet personi fizik dhe juridik nëse:

a).shfrytëzon burimet natyrore pa leje për shfrytëzim(neni -8.1)

- b).fillon realizimin e projektit pa hartimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pa pëlqimin e organit kompetent(neni -23.1);
- c).nuk ndërmerr masa sanimi me shpenzime të veta(neni -25);
- d).kryen veprimtari në të mirat natyrore me rëndësi të veçantë me të cilat rrezikohet kapaciteti i mjedisit,ekuilibri natyror,vlerat natyrore e kulturore(neni 17.2);
- e).largon dhe hedh mbeturinat dhe materiet e rrezikshme në mjedis jashtë lokacioneve të destinuara për këtë(neni -19).

Neni 43

Me gjobë prej 500€ deri në 1000€ për kundërvajtje do të dënohet personi fizik ose personi juridik nëse:

- a).vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 14.2. të Rregullorës;
- b).pengon inspektorin komunal në kryerjen e obligimeve nga neni 40.3 i Rregullores.

Neni 44

Me gjobë prej 300€ deri ne 500 € do te denohet per kundervajtje personi pergjegjes ne organin e administrates,perkatesisht ne organizaten e cila kryen sherbime publike nese nuk informon opinionin dhe nuk nxjerr aktin e fuqizimit te masave ne rastet nga neni 28 i Rregullores.

XIII-DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 45

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË Obiliqit

Nr. _____ Dt: 31/05-2010

